



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 06
Prishtinë, më 25.03.2013, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2.

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novobërdali, Rita Hajzeraj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari dhe Duda Balje.

Munguan: Justina Pula, Albana Gashi, Kimete Bytyçi.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, Sulltane Gashi - zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Të ftuar: ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Slobodan Petroviq dhe ministri i Administratës Publike, z. Mahir Yagcilar, sekretari Fitim Sadiku dhe Naser Shanolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Besnik Osmani, Blerta Miftari dhe Blerim Hansani-MAPL; Florije Kryeziu-UNICEF; Elita Vokshi dhe Lejla Selimi-OSBE; Visar Bivolaku-EUO/EUSK; Edona Peci-BIRN; Lumturie Beha-Kosova Info; Blerta Aliu-Koha Ditore dhe Ukë Gashi-ZPRK.

Mbledhjen e kryesoi Suzan Novobërdali, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më 19 shkurt dhe 13 mars 2013;

3. Shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2011, rreth zbatimit të rekomandimeve që lidhen me ministrinë;
Të ftuar: ministri i Administratës Publike, z.Mahir Yagcillar dhe ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, z.Slobodan Petroviq.
4. Shqyrtimi i kërkesave;
5. Të ndryshme.

Kryetarja – Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më 19 shkurt dhe 13 mars 2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura, më 19 shkurt dhe 13 mars 2013.

3. Shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2011 rreth zbatimit të rekomandimeve që lidhen me ministrinë

Kryetarja – Fillimisht, përshëndeti të pranishmit, si dhe ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, z.Slobodan Petroviq dhe stafin e tij, të cilët i janë përgjigjur ftesës së Komisionit për pjesëmarrje në mbledhje.

Ajo tha se Komisioni ynë ka disa rekomandime të raportit të Avokatit të Popullit.

Janë tri rekomandime që kanë të bëjnë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, siç është rekomandimi që të shtohen fushatat dhe aktivitetet për ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve përgjegjës të institucioneve dhe qytetarëve për qasjen e papenguar në dokumente publike, përmes fushatave informuese (fushatë mediale, fletëpalosje etj.).

Të hartohet procedurë e përshpejtuar gjyqësore për rastet që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike.

Institucionet publike duhet të jenë më të hapura dhe më azhure ndaj kërkesave për qasje në dokumentet publike. Transparenca është gurthemeli i një shoqërie demokratike dhe kusht për luftimin e korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin.

Kryetarja tha se për t'u informuar më në detaje se çka është ndërmarrë nga kjo Ministri, lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve, do të informohemi nga ministri Slobodan Petroviq.

Slobodan Petroviq, ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

- Tha se sa u përket rekomandimeve në raportin e Avokatit të Popullit, në nëntor të vitit 2011, është formuar grupi punues për gjuhët dhe kam qenë kryesues i grupit, ndërsa reformën për gjuhët e ka udhëhequr Zyra e Kryeministrit. Grupi punues e ka prurë udhëzuesin për gjuhët në vitin 2012.

Ai tha se Zyra për çështje të bashkësive, ka formuar një rrjet për politikën e gjuhëve, me përfaqësuesit e institucioneve, organizatave dhe ndërmarrjeve që kryejnë punë publike, të cilat së bashku me Këshillin kanë filluar bisedimet me Avokatin e Popullit në lidhje me shqyrtimin e disa kërkesave që u janë drejtuar këtyre institucioneve për hapat e parë të bashkëpunimit.

Janë bërë ndryshime të softuerëve dhe formularëve nëpër komuna, ndërsa në të ardhmen do të jenë dokumentet në të dy gjuhët zyrtare. Kjo është diçka inkurajuese.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur, tha se i intereson të dijë se sa anëtarë i ka komisioni dhe si është përkatësia e anëtarëve, meqë kemi një rekomandim nga Institucioni i Avokatit të Popullit se duhet të jenë dy përfaqësues të komuniteteve, njëri boshnjak dhe tjetri nga komuniteti rom dhe a janë krijuar kushtet financiare për rekrutimin e përkthyesve, sepse është njëri ndër rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe sa është duke u zbatuar Ligji për përdorimin e gjuhëve në Kosovë.

Slobodan Petroviq – Tha se në këtë lëmi nuk ka pasur rezultate të mjaftueshme, por Qeveria është e angazhuar që të shtojë kapacitetet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Anëtarë të Këshillit janë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve dhe komuniteteve. Është me rëndësi roli i faktorit njeri në këtë punë. Ka pasur pak njerëz të interesuar për këtë punë, e cila kërkon angazhime serioze në çështjen e gjuhëve.

Rita Hajzeraj – Sa i përket zbatueshmërisë së Ligjit për gjuhët zyrtare në Kosovë, përgjegjëse është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Ne kemi një ankesë nga Zoran Stanishiq, i cili e ka dërguar në Zyrën e Institucionit të Avokatit të Popullit, e që ka gjetur përkrahje nga Zyra e Avokatit të Popullit. Konsideroi se ka plotësisht të drejtë personi në fjalë, por nuk është problemi te komunat, por ka probleme në mungesë të ekspertëve dhe përkthyesve. Këtë problem e ka edhe Kuvendi i Kosovës, por kjo kërkesë ka qenë për Zyrën e ofiçarisë në Prishtinë dhe ka marrë përgjigje. Më erdhi mirë që është instaluar një sistem dhe tani pritet veç të funksionalizohet.

Kymete Bajraktari- Bëri pyetje se a është tentuar për të krijuar kushte financiare, për t'u bërë rekrutimi i përkthyesve profesionistë në ato institucione ku ndihet mungesa e tyre, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Si Ministri, çka keni bërë në këtë drejtim?

Slobodan Petroviq – Tha se si ministri kemi pasur shumë aktivitete. Kemi dërguar shumë shkresa, ua kemi tërhequr vërejtjen të gjitha komunave, të cilat janë të detyruara të respektojnë ligjin. Kemi pasur një rol aktiv, por nuk jemi institucion që mund të urdhërojmë. Jam i kënaqur që viteve të fundit kemi gjetur zgjidhje më të mira me partnerët në nivelin lokal.

Kymete Bajraktari – Pyeti ministrin: Në momentin kur ligji nuk zbatohet, cilat janë sanksionet që mund të ndërmerren?

Slobodan Petiviq – Unë jam i kënaqur që kemi pasur rezultate. Ka pasur vendime me kompromis, nuk ka pasur kyçje të institucioneve shtesë. Obligimi ynë është që të respektojmë ligjin. Kemi pasur raste kur i kemi zgjidhur shumë shpejt, ka pasur raste kur ka pasur edhe botëkuptime të tjera, por ka pasur procedura të tjera.

Besnik Osmani – Sa i përket respektimit të Ligjit për gjuhët në nivelin lokal, kemi një plan për t'i ndihmuar komunat. Në këtë drejtim, e para që kemi bërë, është që të ndihmojmë komunat që të krijojnë zyrat për njësitë e të drejtave të njeriut. Sot i kemi 34 të tilla, ndërsa kemi pasur probleme me rregulloret lokale, sepse ato nuk kanë qenë të përkthyer. Ne i kemi mbledhur të gjitha këto rregullore dhe i kemi selektuar dhe po u ndihmojmë komunave për t'i përkthyer dhe për t'i bërë publike. Të gjitha ueb sajtet e komunave i kemi përkthyer në gjuhët zyrtare. Kemi bërë edhe një program për personat me aftësi të kufizuara, që më lehtë të komunikojnë me komunat përmes gjuhës së shenjave dhe ata të marrin shërbime përmes autoriteteve lokale. Ne nuk kemi të drejtë të alokojmë buxhet, por mandati i ministrisë sonë është që t'i ndihmojmë komunat në implementimin e mandatit të tyre.

Biserka Kostiq – Tha se mosrespektimi i gjuhëve është një situatë më se alarmante dhe se një situatë e tillë vjen si nga institucionet qendrore, ashtu edhe nga ato lokale. Një mos respektim të tillë është duke e bërë edhe vetë Institucioni i Avokatit të Popullit dhe se në vet ligjin, nuk ekziston ndonjë rregullore për sanksionim të mosrespektimit të ligjit. Ajo tha se grupi parlamentar në të cilin bën pjesë, përherë apelon për respektim të zbatimit të Ligjit për gjuhët, por problem janë mjetet për të siguruar përkthyes profesionalë dhe se Komisioni ynë duhet të punojë më shumë që ky ligj të gjejë zbatim.

Rita Hajzeraj – Tha se në Kosovë nuk është i vetmi Ligji për gjuhët, i cili nuk gjen zbatim, por sa i përket softuerit që ekziston nëpër komuna, zyrtarët janë ankuar se trajnimi që u është mbajtur, nuk e kanë kuptuar.

Besnik Osmani – Tha se duhet të sqarojë se nuk është fjala për softuerin e ofiçarisë që e ka bërë Ministria e Punëve të Brendshme, sepse me këtë ka probleme niveli komunal. Është e vërtetë që kemi trajnuar 500 deri në 600 zyrtarë komunalë. Ky trajnim ka zgjatur përafërsisht një vit. Kemi dy udhëzime administrative që kanë rregulluar këtë fushë, ndërsa deri sot, kemi vetëm një ankesë sa i përket këtij softueri që unë po i referohem, është nga Komuna e Gjilanit. Ne bëjmë një garë se cila po e përdor më mirë dhe ju japim grande të vogla, në pajtim me ligjin për projekte të ndryshme, ndërsa ato komuna që nuk kanë rezultate të mira, ankohen dhe japin vërejtje. Nuk kemi asnjë ankesë nga ndonjë qytetar se diku në nivelin lokal i është bërë ndonjë padrejtësi në përdorimin e gjuhës së vet.

Kurtan Kajtazi – Tha se ky raport është i vitit 2011 dhe tani presim raportin e vitit 2012. Në këtë raport ankesat janë të vogla, sidomos në problemet që kanë pasur disa komuna, gjegjësisht komunat e reja. Sa i përket rekomandimit të tretë, që thotë se duhet krijuar kushte financiare për rekrutimin e përkthyesve nëpër komuna, nuk ka nevojë, por përkthyesit duhet të jenë profesionalistë. Nga ministria duhet të rekomandohet që ata

përkthyes duhet të zëvendësohen me profesionalistë. Gjithashtu, janë disa paragjykime ku thuhet se njerëzit kanë frikë për të përdorur gjuhën e vet. Kjo frikë tani nuk ekziston. Ai tha se ka disa komuna që kanë gjuhë zyrtare në përdorim, si për shembull gjuha turke në disa komuna ku ka komunitet turk.

Kymete Bajraktari – Si Komision për të Drejtat e Njeriut, jemi angazhuar, si dhe do të angazhohemi për të drejtat e njeriut në përgjegjësi. Ajo tha se deputetja Biserka Kostiq, disa herë ka pasur problem me përkthime, mirëpo këto nuk kanë qenë tendencioze. Nëse duam të bëjë ndryshime, duhet të fillojmë prej vetes për të dhënë kontributin, kështu që deputetja Biserka të kontribuojë në Graçanicë, e pastaj të vazhdojmë më tutje.

Kryetarja – Tha se Komisioni Evropian është i interesuar të dijë sa zbatohen rekomandimet e Avokatit të Popullit, sa zbatohet Ligji për përdorimin e gjuhëve. Unë falënderoj përfaqësuesit për të dhënat që na ofruan, ka vend të bëhet edhe më shumë. Këtu mund të japim edhe ne kontributin tonë me monitorime, që të dimë saktë se ku qëndrojnë problemet, nëse nuk zbatohet ky ligj.

Kryetarja – Tha se tani po kalojmë te rekomandimet, që kanë të bëjnë me Ministrinë e Administratës Publike. Ajo tha se janë tri rekomandime që i dedikohen kësaj Ministrie nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Rekomandimet janë këto: të shtohen fushatat dhe aktivitetet për ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve përgjegjës të institucioneve dhe qytetarëve për qasjen e papenguar në dokumente publike, përmes fushatave informuese (fushatë mediale, fletëpalosje etj).

Të hartohet procedurë e përsheptuar gjyqësore për rastet që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike.

Institucionet publike duhet të jenë më të hapura dhe më azhure ndaj kërkesave për qasje në dokumentet publike. Transparenca është gurëthemeli i një shoqërie demokratike dhe kusht për luftimin e korrupsionit dhe abuzimin me pushtetin.

A i konsideroni ju se këto rekomandime janë me bazë?

Fitim Sadiku, sekretar në Ministrinë e Administratës Publike – Ne kemi pranuar shkresën nga Komisioni juaj dhe do të bëjmë përpjekje të japim përgjigje. Ky raport është i vitit 2011 dhe gjendja në terren ka ndryshuar.

Ne, si Ministri, kemi ndërmarrë një sërë aktivitetesh në këtë drejtim dhe kjo Ministri është ndër të parat që ka plotësuar obligimet që dalin nga Ligji për qasje në dokumentet zyrtare. Fillimisht, në kuadër të Zyrës për komunikim, që ekziston në kuadër të Ministrisë, kemi emëruar personin përgjegjës për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe përcjelljen e tyre te personat kompetentë. Gjithashtu, në ueb faqen zyrtare të MAP-it është hapur një link, nëpërmjet të cilit, personat e interesuar mund të kërkojnë dokumente publike që atyre ju interesojnë.

Si Ministri, kemi pasur 33 kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumente publike, përgjigjet janë dhënë brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Kryetarja – Më vjen mirë për atë që dëgjova se ka ndryshuar situata për të mirë në terren, por nuk e kam të qartë se çka është dashur të thuhet me këtë që të hartohet

procedurë e përshpejtuar gjyqësore për rastet që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike.

Fitim Sadiku – Edhe ne si Ministri, kemi pasur hamendje se çka është dashur të thuhet me këtë dhe cili është qëllimi i saj.

Rita Hajzeraj – Tha se a ka pasur ndonjëherë kërkesa prej Zyrës së Avokatit të Popullit tek Ministria e juaj për kërkesa të ndryshme dhe si bëhet kjo qasje, a është link i veçantë përmes internetit, a regjistrohet personi i cili aplikon për një dokument të caktuar apo mbetet anonim ai person.

Fitim Sadiku – Personit që i intereson një dokument apo informatë, e bën kërkesën me shkrim dhe zyrtari kompetent e bën regjistrimin dhe protokollimin e lëndës, dhe në bazë të afatit të përcaktuar me ligj, në të njëjtën formë, kthejmë përgjigje me shkrim dhe protokollohet për të ditur se a iu kemi përmbajtur afatit. Mënyra tjetër është përmes emailit dhe linkut.

Kemi një komision që bën klasifikimin e dokumenteve dhe atëherë e kemi më lehtë që të dimë se cilat dokumente janë për qasje, cilat janë dokumente për qasje të kufizuar, të pjesshme dhe në cilat ndalohet qasja.

Kurtan Kajtazi –Tha se Kuvendi ka bërë qartësimin e informacioneve të klasifikuara, edhe pse janë miratuar aktet nënligjore përkatëse, ka paqartësi në praktikë rreth këtyre se cilës kategori i takojnë këto informacione, a është bërë diçka në këtë drejtim.

Fitim Sadiku – Si Ministri, në bazë të ligjit, kemi formuar grupin punues dhe është duke bërë klasifikimin e dokumentacionit. Gjithashtu, ka përgatitur draftin e parë të dokumenteve që janë të ndjeshëm, mirëpo ende nuk është përfunduar. Shumë shpejt, ky grup, do të dalë me një dokument dhe do të bëjë klasifikimin e dokumenteve në përputhje me propozimet që do të vijnë nga grupi punues. Ne do të ecim tutje me rangimin e këtyre dokumenteve.

Kymete Bajraktari –Tha se nëse Ministria e juaj e sheh të arsyeshme dhe konsideron se një dokument nuk bën t’i jepet palës, atëherë ku ankohet pala për të pasur qasje në atë dokument.

Fitim Sadiku – Tha se ligji ka paraparë edhe shkallën e dytë të ankesës, në rast se nuk merr përgjigje, por ne si Ministri nuk kemi pasur raste të tilla, por me siguri pala do të marrë përgjigje me shkrim se cilat janë rrugët që duhet t’i ndjekë.

4. Shqyrtimi i kërkesave

Rita Hajzeraj – Tha se grupi punues për shqyrtimin e peticioneve, ka shqyrtuar disa kërkesa. Një kërkesë kemi nga K.R. i cili ka konkurruar për arsimtar të gjuhës angleze, sigurisht jeni të njoftuar me këtë shkrese. Ne kemi kërkuar informacione shtesë nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prizrenit, por ata na janë përgjigjur me

dokumentacionin e personit në fjalë, por nuk na kanë ofruar dokumentacion sa i përket kundër kandidatit, i cili është pranuar, prandaj për të bërë krahasimin, ne propozojmë që të kërkohet edhe dokumentacioni i kandidatit që është pranuar në punë, si dhe kriteret, procedurat dhe poentimi që është marrë për bazë për pranimin e tij në punë.

Komisioni u pajtua unanimisht që të kërkohet nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prizrenit edhe dokumentacioni i kundër kandidatit të K.R.

Rita Hajzeraj – Kemi raport special drejtuar Qeverisë së Kosovës nga Avokati i Popullit, për vlerësimin e ligjshmërisë për licencimin e avokatëve të huaj në Kosovë.

Komisioni vendosi që kjo kërkesë të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Rita Hajzeraj – Tha se kemi shqyrtuar edhe njoftimin e Institucionit të Avokatit të Popullit për ankesën e Z. S. nga Komuna e Prishtinës, se nuk po respektohet Ligji për gjuhët, pasi që shërbimi i ofiqarisë nuk ka mundësi të lëshojë plotësisht formularët në gjuhën serbe, për arsye teknike, sepse softueri nuk ua mundëson që të bëjnë përmirësimet e domosdoshme. Kjo çështje është e lidhur me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Pas një debati konstruktiv, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni, lidhur me këtë ankesë, kërkon nga Ministria e Punëve të Brendshme informatë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Rita Hajzeraj – Tha se kemi kërkesën e M.M. nga Gjilani, e cila është larguar nga puna dy muaj pasi ka hyrë në pushimi të lehonisë.

Për këtë, ne kemi kërkuar informatë nga Inspektorati i Punës, që është përgjegjës për këtë çështje. Tani jemi në pritje të përgjigjes nga Inspektorati i Punës.

Kurtan Kajtazi – Tha se grupi punues ka shqyrtuar shkresën që është drejtuar nga Kryesia e Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së mësimdhënësve, për t’ua njohur stazhin e punës prej vitit 1991 deri në vitin 1999.

Komisioni, pas një debati konstruktiv lidhur me statusin e mësimdhënësve të kësaj periudhe, unanimisht vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

Rekomandim

- I. T’u njihet stazhi i punës mësimdhënësve dhe personelit të punësuar në arsim nga periudha e vitit shkollor 1990/91, deri në vitin shkollor 1998/00.
- II. Të obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës, që të nxjerrë akt nënligjor për zbatimin e këtij rekomandimi.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novobërdali